



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:163623

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05972002

**P.nr.497/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,** gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit Q.M nga fsh. N, komuna Pejë, tani me vendbanim në Gj, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.497/2021 të dt.14.02.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 06.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit Q.M dhe mbrojtëses së tij sipas autorizimit, av. Qëndresa Muriqi Mekaj nga Peja, me datë 07.06.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.07.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

**Q.M** nga i ati Sh dhe nëna Z, e gjinisë Gj, i lindur me datë ..... në fsh. B –R, Komuna Pejë, me vendbanim në Gj, ka të kryer shkollën ....., biznesmen, i ..... , gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër ..... të lëshuar nga R.E Gjermanisë, me nr.tel ....., shqiptar, shtetas i Gjermanisë, mbrohet në liri, i pa dënuar më parë.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë ....., rreth orës ..... min, në rrugën „R.H” në Pejë, nga pakujdesia shkel Ligjin për rregullat e trafikut rrugor, përkatësisht nenin 151 par.1 dhe rrezikon jetën e njerëzve, ku i shkakton lëndime të rënda trupore tjetrit dhe atë fëmijës J.B, në atë mënyrë gjersa i pandehuri ishte me automjetin e tij të tipit „.....” me ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit..... (.....), duke lëvizur në rrugën e lartcekur në drejtim të varrezave të .....t me të arritur përballë shtëpisë së të dënuarës, e cila kishte zbrit nga automjeti së bashku me nënën e saj dhe

pa mbikëqyrje të duhur vrapon në drejtim të shtëpisë, ku në ato momente nga moskujdesi i të pandehurit dhe nënës së të dëmtuarës vie deri te aksidenti përplasjet me pjesën e parë në anën e majtë të automjetit të të pandehurit, ku nga kjo goditje pëson gjakderdhje nën cipat e forta të trurit në të dy anët, thyerje të kafkës në pjesën tërthore-murore të majtë dhe thyerjen e bazës së kafkës.

-me çka ka kryer veprë penale „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7,8, 38, 39, 40, 42, 44, 64, 69, 70, neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, neni 364, 365, 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6, 450, 452 par. 1, 462 par.2 të KPPRK-së, gjykata të pandehurin e:

## GJYKON

- I. Me dënim me burgim** ne kohëzgjatje prej **njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh**, i cili dënim në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me:
- II. DËNIM ME GJOBË** - shumën në lartësi prej **tremijë (3.000) euro**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform neni 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku **20 € (njëzetë euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.**
- IV.** I pandehuri obligohet gjykatës t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, dhe shpenzimet e ekspertizës së komunikacionit rrugor shumën prej **51.10 € ( pesëdhjetë e një euro e dhjetë cent )**, e të gjitha **në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- V.** I pandehur obligohet ta paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- VI.** Të pandehurit i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES**
  - **NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT** te të gjitha kategorive dhe atë për periudhën një (1) vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VII.** Përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar I.b me vendbanim në Pejë Rr., R.H'' nr... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### *A r s y e t i m*

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1316/2021 të datës 26.07.2021, kundër të pandehurit Q.M nga fsh. N, Komuna Pejë, tani me vendbanim në Gj, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale „Rrezikim i trafikut publik'' nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti seancë të shqyrtimit fillestar me datë 06.06.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë Ermal Demhasaj, të pandehurit Q.M mbrojtëses së tij sipas autorizimit av. Qëndresa Muriqi Mekaj, ndërsa mungonte e dëmtuara edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo në seancë nuk prezantoi dhe mungesën nuk e arsyetoi.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për natyrën dhe pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPRK-së.

I pandehuri e vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, deklaroi se në mënyrë vullnetare, pa presion e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës, e pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i pandehuri e ka bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë pa presion dhe pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të pandehurit duke u pajtuar me deklaratën e të mbrojturit të saj të dhënë lidhur me fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, i propozoj gjykatës të njëjtën ta aprovoj.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPRK-së miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale „Rrezikim i trafikut publik'' nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat materiale nga aktakuza siç janë :Ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eks. Naser Nimanaj dt.21.07.2021, akt ekspertiza mjeko-ligjore e punuar nga dr. Driton Haliti PE 303/21 e dt.19.07.2021, procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit dr.05.07.2021, raporti i aksidentit me nr.0327509, i dt.31.05.2021, fletë lëshimi i QKUK-së, Klinikës së pediatriisë, me nr. 3010 e dt.16.06.2021, skica e vendit të ngjarjes, procesverbali i marrjes së deklaratës së përfaqësueses ligjore dëshmitares I.B në prokurori me dt. 23.07.2021, procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit Q.M në prokurori me datë 26.07.2021.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin të merret parasysh pranimin e fajësisë ndërsa si rrethanat rëndësuese të merren mosha e viktimës dhe dënimet e mëparshme eventuale të të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoi që si rrethanë lehtësuese për të mbrojturin e saj të merret parasysh pranimi i fajësisë, sjellja e tij korrekte gjatë gjithë procedurës, faktin se i njëjti i ka kërkuar falje familjarëve të të dëmtuarës, i ka kompensuar duke shtuar se i njëjti asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin, gjithashtu theksoj nga ekspertiza rezulton se ditën kritike në rrezikimin e trafikut publik ka kontribuar edhe nëna e të dëmtuarës. Sa i përket rrethanave rënduese të propozuara nga PSH i propozoi gjykatës që ti refuzoj për arsye me ligji nuk i parasheh si rrethana rënduese, andaj në raport me propozimin për marrjen e lejes së vozitjes i propozoj gjykatës që kërkesën ta refuzoj faktin se i mbrojturi i saj jeton në Gjermani dhe gjatë tërë kohës udhëton për biznes, është mbajtës i familjes dhe marrja e lejes së vozitjes do t'ia vështirësonte jetën atij dhe gjithë familjes, andaj kërkoi nga gjykata që të mbrojturit të tij t'i shqiptohet dënim i kushtëzuar i cili do ta arrinte qëllimin e dënimit.

I pandehuri deklaroi se pajtohet me fjalët e mbrojtëses, njëkohësisht edhe i kërkon falje palës së dëmtuar.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Q.M qëndrojnë të gjitha elementet e veprës „Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit, i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer nga pakujdesia.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese gjykata pati parasysh faktin se viktimja është fëmija e moshës 3 vjeçare, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin morri parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana tjera lehtësuese morri sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, faktin se

sipas ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eks. ing. Naser Nimanaj, rezulton se deri te aksidenti ka ardhur me kontributin e drejtuesit të automjetit, këtu të pandehurit dhe mbikëqyrëses-nënës së fëmijës, këtu përfaqësuesja ligjore e të dëmtuarës, faktin se vepra është kryer nga pakujdesi dhe për të pandehurin është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Sa i përket dënimit të shqiptuar të pandehurit, gjykata në rastin konkret, pas parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit si rrethane posaçërisht lehtësuese, ka aplikuar nenin 71 dhe 72 të KPRK-së dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, konform nenit 72 par. 1 nën par. 1.6 të KPRK-së ku parashihet së “ nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim;” ashtu që fillimisht i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditë, dhe njëkohësisht në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së i ka dhënë mundësinë që ky dënim të zëvendësohet me dënim me gjobë, ashtu që i njëjti përmes mbrojtëses së tij përmes parashtrësës kanë dhënë pëlqim që dënimi i shqiptuar me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtit ia zëvendësoi dënimin me burgim në dënim me gjobë.

Gjykata propozimin e prokurorisë lidhur me dënimin plotësues „Marrja e lejes së vozitjes”, nuk e shqiptoi pasi që i pandehuri është shtetas i huaj dhe posedon patentë shoferë të shtetit tjetër. Andaj, meqenëse gjykata nuk është e lidhur me propozimin e Prokurorisë, të pandehurit ju shqiptua dënimi plotësueses „Ndalimi i drejtimit të automjetit” të të gjitha kategorive dhe atë për periudhën një (1) vjeçare, e cila ndalesë do të zbatohet nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e kjo me bindjen se ky dënim plotësues së bashku me dënimin kryesor do të ndikoj të i pandehuri për rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë që duhet të ketë si pjesëmarrës në komunikacion. Ky dënim plotësues u shqiptua në bazë të nenit 64 të KPRK-së ku thuhet "Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Gjykata cakton kohëzgjatjen e dënimit të urdhëruar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtë se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi".

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor dhe në emër të ekspertizave dhe atë mjeko ligjore dhe atë të komunikacionit rrugor, është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit të përcaktuar si më lartë, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën, gjykata e udhëzoi në kontest juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.497/2021, me datë 05.07.2024.**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

---

**Gylaj Nepola**

---

**Ilda Cucović Sahatçiu**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

**Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.**